



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 480/5 prot.

Tiranë, më 11.11.2021

<b>Lënda:</b>	Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 442, datë 14.9.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Juljan Çafka
<b>Baza ligjore:</b>	Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
<b>Për kompetencë:</b>	Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
<b>Për dijeni:</b>	Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
<b>Depozituar pranë:</b>	Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.10.2021, është njoftuar vendimi nr. 442, datë 14.9.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Juljan Çafka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 442, datë 14.9.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, ushtron detyrën e prokurorit dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP).

2.1. **ILDKPKI**, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit, z. Juljan Çafka”<sup>2</sup>, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. **DSIK**, me anë të Raportit<sup>3</sup> të përditësuar mbi Kontrollin e Figurës të z. Juljan Çafka, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit: [...] nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Juljan \*\*\* Çafka [...].

2.3. **KLP**, me anë të Raportit<sup>4</sup> për Analizimin e Aftësive Profesionale të prokurorit Juljan Çafka, ka analizuar aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale dhe aftësitë personale, dhe angazhimin profesional, bazuar në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat dhe burimet arkivore nga sistemi i Prokurorisë.

3. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, janë si vijon:

3.1. **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë [...] (f. 57 e vendimit).

3.2. **Për kontrollin e figurës.** [...] Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka, nuk u arrit të provohet papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...] (f. 57 e vendimit).

3.3. **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i çështjeve të hetuara nga subjekti është i pamjaftueshëm për të arritur në vlerësimin e tij, sipas germave “b” dhe “c” të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr.

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2019.

<sup>3</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2020, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2020.

<sup>4</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2019, i KLP-së.

84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin nivel kualifikues, sipas neneve 44/a dhe 59/c, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 57 e vendimit).

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 442, datë 14.9.2021, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, ka vendosur: [...] 1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. *Juljan Çafka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë*”, dhe në pikën 2 të dispozitivit: [...] 2. Transferimin e çështjeve penale...nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2018... dhe nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2019..., në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**5.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (*Vetting*).

**6.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si *Kolegji*).

**7.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**8.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe në një vlerësim të drejtë të provave të administruara.

**9.** Në datën \*\*.11.2021, mes të tjerave, në Institucionin e Komisionerëve Publikë, është protokolluar denoncimi i shtetasit \*\*\*,\*\*\*,<sup>5</sup>, i cili përmbush kushtet e pranueshmërisë, në kuptim të nenit 53, “*Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve*”, të ligjit nr. 84/2016, dhe përmban çështje për të cilat konstatohet se është i nevojshëm një hetim i mëtejshëm, bazuar në kriteret përkatëse të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. *Juljan Çafka*.

**10.** Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që, brenda juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, ky i fundit, në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor, për hetimin e këtyre çështjeve të reja dhe të pahetuara.

**11.** Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 442, datë 14.9.2021, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

---

<sup>5</sup> Ankim i z. \*\*\*,\*\*\*, administrator i \*\*\* sh.p.k. - NUIS \*\*\*, protokolluar në IKP me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021.

### III. Shkaqe të ankimit për hetim të mëtejshëm

12. Referuar përmbajtjes së denoncimit të shtetasit \*\*\*,\*\*\*, drejtuar një sërë institucionesh, protokolluar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën \*\*.11.2021, çështjet penale për të cilat është vendosur mosfillim procedimi penal, të hetuara apo të përfaqësuara në gjykim, nga subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, shtrihen në periudhën e viteve 2014-2021, nga të cilat Komisioneri Publik parashtron si në vijim:

12.1. *Procedimi penal me nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2017, për kryerjen e veprës penale: “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal*

12.1.1. Referuar të dhënave të dala nga përmbajtja dhe dokumentacioni shoqërues i *denoncimit (protokolluar më datë \*\*.11.2021)*, pretendohet se subjekti i rivlerësimit, me veprimet hetimore të procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2017, të regjistruar për kryerjen e veprës penale *“Shpërdorim i detyrës”*, ka zvarritur me qëllim hetimin e çështjes për vite me radhë, me qëllim favorizimin e një funksionari të zgjedhur vendor. Po ashtu, referuar denoncimit, kryerja e hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit është realizuar në shkelje të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, duke u kërkuar përfundimisht nga ana e tij, pushimi i këtij procedimi penal, rrëzuar kjo kërkesë me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë.

12.1.2. Nga shqyrtimi i kopjes së aktit, bashkëlidhur denoncimit, identifikuar si vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, konstatohet sa vijon:

12.1.2.1. Shtetasi \*\*\*,\*\*\*, në datat \*\*.5.2017 dhe \*\*.6.2017, ka paraqitur një kallëzim në Prokurorinë Gjirokastrë, ku, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet falsifikimit dhe duke shpërdoruar detyrën, ka arritur të miratojë kontraktimet e marrjes me qira të një prone private dhe më pas tenderimin e ndërtimit të tregut industrial, duke shkelur çdo rregull urbanistik dhe duke kryer procedime tenderimi në mënyrë të dyshimtë. Bashkia Gjirokastrë ka anashkaluar qëllimisht hallka dhe procedura ligjore me qëllim përfitimi. Ndërtimi i tregut është jashtë çdo standardi, si dhe ka ndërhyrje për të ndryshuar hartat dhe plan-vendosjet e pronave [...].*

12.1.2.2. Prokuroria Gjirokastrë, pas regjistrimit të procedimit penal përkatës, në datën \*\*.6.2017, ka kryer disa veprime hetimore, ndër të tjera, duke administruar praktika shkresore nga Bashkia Gjirokastrë, Këshilli Bashkiak, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, akt-ekspertimin topografik, dhe akt-ekspertimin tekniko-vlerësues. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2017. Nga përmbajtja e akteve, bashkëlidhur denoncimit, kjo kërkesë e organit të Prokurorisë është regjistruar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, në datën \*\*.11.2020.

12.1.2.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2021, ka vendosur mosmiratimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve, bazuar në nenin 329, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale dhe duke qenë se subjekti, z. Çafka, ushtron edhe detyrën e prokurorit të Rrethit, Gjykata ka konsideruar të përmbushur edhe

detyrimin e parashikuar në pikën 5<sup>6</sup> të nenit 329, të Kodit të Procedurës Penale. Nga aktet, bashkëlidhur denoncimit, nuk konstatohen shënime në lidhje me faktin në rast se, bazuar në nenin 329/b, paragrafi 6 i K. Pr. P., të jetë ushtruar ankim nga ana e organit të Prokurorisë.

12.1.2.4. Nisur nga përmbajtja e arsytimit të vendimit gjyqësor të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, në lidhje me zbatimin e dispozitës së nenit 75/a të K. Pr. P., konstatohet se pretendimi i denoncuesit, bazohet në argumentet e përdorura nga Gjykata, kur referon faktin se Prokuroria Gjirokastrë<sup>7</sup> nuk ka regjistruar emrin e personit, të cilit i atribuohet vepra penale e parashikuar nga neni 248, “Shpërdorimi i detyrës”, i Kodit Penal, por ka përdorur, gjatë hetimeve për identifikimin e subjektit, termin e përgjithshëm: *Bashkia Gjirokastrë*, duke shmangur eventalisht zbatimin e nenit 75/a të K. Pr. P.

12.1.2.5. Sa më lart, konstatohet nevoja e hetimit të mëtejshëm nga ana e Kolegjit, lidhur me: (i) verifikimin e shkaqeve që kanë sjellë kohëzgjatjen e hetimit nga momenti i regjistrimit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2017, deri në paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal, datë \*\*.11.2020, referuar nenit 327 të K. Pr. P.; (ii) verifikimin e subjekteve, të cilëve u atribuohet vepra penale, regjistrimi i tyre referuar nenit 287 të K. Pr. P. dhe zbatimi eventual i dispozitës së nenit 75/a, lidhur me nenin 80, të Kodit të Procedurës Penale, në përcaktimin e kompetencës lëndore, në hetimin e procedimit penal, referuar edhe detyrave të lëna nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2021.

12.1.3. Në lidhje me nevojën e hetimit lidhur me këtë procedim penal, Komisioneri Publik vlerëson se është i nevojshëm: (i) administrimi i dosjes penale që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2017, duke iu drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë.

## 12.2. Ekzekutimi i vendimeve penale në ngarkim të shtetasit \*\*\*,\*\*\*

12.2.1. Referuar të dhënave nga përmbajtja dhe dokumentacioni shoqërues i *denoncimit (protokolluar më datë \*\*.11.2021)*, pretendohet se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, në kuadër të ekzekutimit të vendimeve penale të Gjykatës së Gjirokastrës, ka tejkalluar afatet ligjore për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor, si dhe shpalljen në kërkim ndërkombëtar për shtetasin \*\*\*,\*\*\*.

12.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit, rezulton sa vijon:

12.2.2.1. Me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, për të pandehurin \*\*\*,\*\*\* është vendosur deklarimi fajtor për veprën penale: “Pengime për ekzekutimin e vendimit gjyqësor”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*, datë \*\*.3.2018, të Gjykatës së Apelit, Gjirokastrë.

---

<sup>6</sup>“5. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 3, shkronjat “b” dhe “c”, dhe paragrafi 4, të këtij neni, vendimi i njoftohet edhe drejtuesit të Prokurorisë”, ku prg. 3: “b) kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë”; si dhe: “c) kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq”. Prg. 4: “4. Gjykata nuk mund të urdhërojë prokurorin që të formulojë akuzë për persona të tjerë, emri i të cilëve nuk është regjistruar sipas nenit 287 të këtij Kodi. Kur nga aktet rezultojnë të dhëna për vepra penale të tjera, që ndiqen kryesisht ose në ngarkim të personave të tjerë, gjykata mund të kërkojë që të kryhen hetime, edhe në rastet kur vendos sipas shkronjës “c”, të paragrafit 3, të këtij neni”.

<sup>7</sup> Në mungesë të akteve të fashikullit të procedimit penal për të identifikuar prokurorin që ka kryer veprimet hetimore për këtë çështje, referohemi si Prokuroria.

Me urdhrin nr.\*\*\*, datë \*\*.5.2018, ky vendim është vënë në ekzekutim. Praktika për shpalljen në kërkim ndërkombëtar të tij është dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, më datë \*\*.6.2019.

12.2.2.2. Me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, për shtetasin \*\*\*.\*\*\*, është caktuar masa e sigurisë “Arrest me burg”, për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, dhe pas shpalljes në kërkim të tij, praktika për shpalljen në kërkim ndërkombëtar të tij është dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, më datë \*\*.12.2019.

12.2.3. Sa më lart referuar, konstatohet nevoja e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit nëse veprimet procedurale janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, dhe nëse është zbatuar në mënyrë korrekte legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale, ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, dhe ligji nr.10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar.

12.2.4. Në lidhje me nevojën e hetimit lidhur me këto dy çështje, Komisioneri Publik vlerëson se është i nevojshëm: (i) administrimi i praktikës dokumentare të nxjerrjes së urdhrave për ekzekutimin e vendimeve penale në ngarkim të të dënuarit \*\*\*.\*\*\*, duke iu drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, konkretisht për: (i.1) vendimin penal nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, lënë në fuqi nga vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2018, i Gjykatës së Apelit, Gjirokastrë, dhe (i.2) vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

12.3. *Procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2017, në ngarkim të shtetasit \*\*\*.\*\*\**

12.3.1 Referuar të dhënave nga përmbajtja e *denoncimit (protokolluar më datë \*\*.11.2021)*, pretendohet se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, në procedimin penal me nr. \*\*\*, viti 2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 186, “Falsifikimi i dokumenteve”, i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, ka zvarritur mbi 4 vjet hetimet për këtë procedim, duke vepruar në kundërshtim me nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim favorizimin e palëve të kallëzuara, duke çuar drejt parashkrimit të ndjekjes penale.

12.3.2 Nga shqyrtimi i denoncimit, nuk rezulton të jetë bashkëlidhur ndonjë akt i lidhur me këtë procedim penal, porse denoncuesi pretendon se ka bërë një kallëzim penal për shtetasin \*\*\*.\*\*\*, pasi, nëpërmjet mashtrimit, i ka vjedhur një sasi të konsiderueshme të hollash, fakt për të cilin ka filluar procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 143/3, “Mashtrimi”, i Kodit Penal, dhe ky shtetas është dënuar për këtë vepër penale.

12.3.3 Në kuadër të këtij procedimi penal është ndarë një tjetër procedim penal, ai me nr. \*\*\*, i vitit 2017, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, i cili pretendohet se hetohet nga subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka.

12.3.4 Sa më lart referuar, konstatohet nevoja e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit nëse është subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, prokurori i çështjes procedim penal nr. \*\*\*, viti 2017, dhe respektimit të afateve të hetimit të saj, në kuptim të nenit 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.

12.3.5 Në lidhje me nevojën e hetimit lidhur me këtë procedim penal, Komisioneri Publik vlerëson se është i nevojshëm: (i) administrimi i dosjes penale që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017, duke iu drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë.

12.4. *Procedim penal për veprën penale: “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal*

12.4.1. Referuar të dhënave nga përmbajtja e denoncimit (protokolluar më datë \*\*.11.2021), pretendohet se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, në procedimin penal për veprën penale të parashikuar nga neni 287, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*.\*\*\*, ka favorizuar palën e kallëzuar, duke mos vendosur sekuestrimin e një pasurie të llojit “apartament”, me vendndodhje në qytetin e Tiranës, blerja e të cilit pretendohet të jetë realizuar më të ardhura të realizuara nga kryerja e veprës penale, çka ka sjellë si pasojë tjetërsimin e pronësisë së kësaj pasurie tek të tretë.

12.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit dhe shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në përmbajtjen e akteve të fashikujve, që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2013, në ngarkim të pandehurve, \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, rezulton sa vijon:

12.4.2.1. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor për procedimin penal nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.5.2016, ka deklaruar fajtorë të pandehurën \*\*\*.\*\*\*, për kryerjen e veprës penale të “Mashttrimit”, me pasoja të rënda, parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 143 të Kodit Penal, vendim i lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2016, të Gjykatës së Apelit, Gjirokastrë. Ky procedim penal ka filluar bazuar në referimin e bërë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, pas denoncimit të shtetasit \*\*\*.\*\*\*.

12.4.2.2. Referuar kërkesës datë \*\*.9.2015, të organit të Prokurorisë për gjykimin e çështjes, kërkesë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, Prokuroria ka parashtruar si vijon: [...] *për hetim të çështjes është verifikuar edhe pasuria e të pandehurve dhe rezulton sipas shkresës me nr.\*\*\* prot., datë \*\*.6.2013. të ZVRPP-së Tiranë, se në emër të \*\*\* e \*\*\*.\*\*\*, që janë prindërit e të pandehurës \*\*\*.\*\*\*, figuron i regjistruar një apartament me sipërfaqe 74.1m<sup>2</sup>, apartament që, sipas hetimeve, rezulton se është blerë me lekët që e pandehura, \*\*\*.\*\*\*, i ka marrë nëpërmjet mashtrimit të shtetasit \*\*\*.\*\*\* [...].*

12.4.3. Sa më lart referuar, konstatohet nevoja e një hetimi të mëtejshëm lidhur me verifikimin e ecurisë së procedimit penal për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në drejtim të sekuestros së pasurisë dhe vendimmarrjes eventuale të Gjykatës, gjatë kontrollit të këtij vendimi, gjatë kryerjes së veprimeve hetimore.

12.4.4. Në lidhje me nevojën e hetimit lidhur me këtë procedim penal, Komisioneri Publik vlerëson se është i nevojshëm: (i) administrimi i dosjes penale<sup>8</sup> për veprën penale: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*.\*\*\*, duke iu drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë.

**13.** Komisioni, në referencë të arsytimit të vendimit përkatës, ka vlerësuar se subjekti arrin një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale dhe duhet të konfirmohet në detyrë. Në të njëjtën kohë, Komisioni ka vendosur që disa nga çështjet, ku evidentohen mangësi të lidhura me

---

<sup>8</sup> Denoncimi, i protokolluar më datë \*\*.11.2021, nuk ka referenca lidhur me numrin e procedimit penal dhe vitin.

profesionalizmin e subjektit, t'ia transferojë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Çështjet e transferuara janë si vijon:

- *procedimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, pezulluar me vendimin e kësaj prokurorie në datën \*\*.8.2020;*
- *procedimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër.*

13.1. Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e vetë Komisionit mbi çështjet e mësipërme, në varësi edhe të rezultateve të hetimit, të kërkuar nëpërmjet këtij ankimi (pika 12 më sipër), do të ndikonin në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**14.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

**15.** Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit C/2, Ç dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se, në rastin konkret, zbatimi i nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 mund të rezultojë vetëm pas hetimit të mëtejshëm të këtyre çështjeve;

**16.** Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Lënien në fuqi të këtij vendimi

ose

- Ndryshimin e vendimit nr. 442, datë 14.9.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Ankimi me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2021, i z. \*\*\*.\*\*\*., administrator i \*\*\* sh.p.k. - NUIS \*\*\*, protokolluar në IKP me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021.